

STATUT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CITY ART” sh.p.k.

Sot më datë 26/10/2023, ortakët e shoqërisë “CITY ART” sh.p.k., duke u bazuar në ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, në ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 për “Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar; ligjin nr.131/2015, datë 26.11.2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, në ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, hartojnë statutin e kësaj shoqërie.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Emri dhe themeluesit

- 1.1 Shoqëria “CITY ART” sh.p.k. është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).
- 1.2 Themeluesit e Shoqërisë janë:
- Z. **Elton Doma.**, i biri i Ramazanit, i datëlindjes 06.09.1977, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, dhe mbajtës i kartës së identitetit me nr 035730758 dhe me nr ID H70906107S.
 - Z. **Klodian Doma.**, i biri i Ramazanit, i datëlindjes 19.08.1979, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, dhe mbajtës i kartës së identitetit me nr 035722104 dhe me nr ID H90819113L.
 - Z. **Gentian Lari**, i biri i Ramazanit, i datëlindjes 13.07.1974, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, dhe mbajtës i kartës së identitetit me nr. 037070563 dhe me nr ID H40713051C
 - Z. **Aldo Muça**, i biri i Skender, i datëlindjes 18.10.1980, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, dhe mbajtës i kartës së identitetit me nr. 035360384 dhe me nr ID I01018151F
 - Z. **Daniel Shima**, i biri i Ibrahim, i datëlindjes 19.08.1975, lindur në Tiranë, banues në Tiranë, dhe mbajtës kartës së identitetit me nr.039102269 dhe me nr ID H50819040V

Neni 2

Objekti

- 2.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë Bar restorant, shërbim catering dhe delivery.

Neni 3


Selia

- 3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga Mustafa Matohiti, Pallati Nr. 1, Ambienti Nr. 6, Tirane**

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.



KREU II
KAPITALI I SHOQËRISË (ZMADHIMI, ZVOGËLIMI, TRANSFERIMI)

Neni 5
Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100.000 Lekë**.
- 5.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kuotat e tyre.
- Ortaku themelues **z.Elton Doma** zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **40,000 lekë**, që përbën **40%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - Ortaku themelues **z.Klodian Doma** zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **5,000 lekë**, që përbën **5%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - Ortaku themelues **z.Gentian Lari** zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **5,000 lekë**, që përbën **5%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - Ortaku themelues **z.Aldo Muça** zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **25,000 lekë**, që përbën **25%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - Ortaku themelues **z.Daniel Shima** zotëruesi 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **25,000 lekë**, që përbën **25%** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 6
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet e derdhura nga ortakët, sipas procedurave ligjore të parashikuara për këtë rast. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.2 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7
Transferimi i kuotave

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut, duke respektuar të drejtën e parablerjes nga ortakët ekzistues të shoqërisë

KREU III
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8
Organi vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;

- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.2 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9


Thirrja e asamblesë së përgjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", nga ligje të tjera ose sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 9.2 Asambleja e përgjithshme mund të thirret nga administratorët ose nga një ose disa ortakë qëpërfaqësojnë më shumë se 5 % të kapitalit themeltar.

Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 10.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 10.3 Asambleja mund të thirret dhe jashtë selisë së shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë saj.
- 10.4 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen dhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i lejohet të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve. Asambleja konsiderohet se është mbledhur, në vendin ku ndodhet kryetari dhe sekretari i mbledhjes.
- 10.5 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht dhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tere kapitalin themeltar.



Neni 11 Kuorumi

- 11.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 11.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.
- 11.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorunit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12 Marrja e vendimeve

- 12.1 Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.2 Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 12.3 Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 13 Përjashtimi nga e drejta e votës

- 13.1 Ortakët nuk mund të ushtrojnë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tyre;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tyre;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tyre nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- 13.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 14 Administrimi

- 14.1 Administratori i parë i shoqërisë caktohet **Z. Elton Doma** me Nr ID H70906107S për një periudhë 5 vjeçare.
- 14.2 Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer veprimet e administrimit në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, nëpërmjet kompetencave që i janë përcaktuar në këtë statut. Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e asamblesë së ortakëve.

- 14.3 Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqërisë apo të tretëve, për shkelje të ligjeve, dispozitave të këtij statuti apo për faje gjatë administrimit të shoqërisë.
- 14.4 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posacëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15

Kompetencat e Administratorëve

- 15.1 Të sigurojë drejtimin e mirë të shoqërisë, të administrojë pasurinë e Shoqërisë, të përfaqësojë Shoqërinë në marrdhëniet me të tretët, të përfaqësojë Shoqërinë para organeve gjyqësore ose autorizon persona të tjerë kompetentë, të kryejë veprime në emër dhe për llogari të shoqërisë me të tretët si: lidh kontrata, kryen veprime të ndryshme bankare, doganore, tregtare e financiare, të punësojë dhe pushojë nga puna personelin që do të zgjidhet nga ai.
- 15.2 Të realizojë cdo veprimtari tjetër kontraktore ose jashtëkontraktore që është në interes të shoqërisë.
- 15.3 Të kerkojë t'i jepen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjëndjen tregtare të shoqërisë si dhe të gjitha dokumentat e shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike etj

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorëve

- 16.1 Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara ose nëpërmjet përfaqësuesve që krijon ai.
- 16.2 Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjet e shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.
- 16.3 Në rast se kërkohet nga ligji, kontrolli i shoqërisë kryet nga një ekspert kontabël i cili emërohet dhe shkarkohet nga Administratori.

KREU IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni 17

Viti financiar

- 17.1 Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.
- 17.2 Bilancet vjetore, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, nëse është emëruar, miratohen nga Asambleja me shumicën e përcaktuar sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.3 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 muajve nga fundi i vitit financiar.

Neni 18

Fitimet

- 18.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% të destinuara për rezervën ligjore deri në 10% të kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja vendos të vërë mënjane, u shpërndahen ortakëve në proporcion me kuotat e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 18.2 Asambleja mund të vendosë dhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

Neni 19
Ekspertët

- 19.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar.
- 19.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 19.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.
- 19.4 Eksperti kontabël i licensuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.


KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 20
Prishja dhe likuidimi

- 20.1 Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit";
 - d) me vendim të gjykatës;
- 20.2 Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".
- 20.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët. Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 21
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin përkatës për shoqëritë tregtare.



Neni 22
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit përkatës për shoqëritë tregtare, ligjit përkatës për regjistrimin e biznesit; ligjit përkatës për qendrën e biznesit, Kodit Civil, ligjit nr.8901, ligjit përkatës për falimentimin; si dhe çdo ligj tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe te tretëve, në rast se ato nuk zgjidhen me mirëkuptim, për shqyrtimin e tyre do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 24
Gjuha

22.1 Ky statut është i shkruar në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe.

Lexuar, gjetur konform vullnetit të lirë e të pavesuar, pranuar dhe nënshkruar nga ortakët themelues:

ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“CITY ART” sh.p.k.

Aldo MUÇA Klodian DOMA Elton DOMA Gentian LARI Daniel SHIMA

Aldo Muça
Klodian Doma
Elton Doma
Gentian Lari
Daniel Shima